

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	IA VLEN: Platforma shqiptare po lehtëson vendimet financiare
ADRESA	https://a2news.com/argetim/teknologji/ia-vlen-platforma-shqiptare-po-lehteson-vendimet-financiare-i1185111
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:33:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	678681ea7d44792b44c5f7b430c9418e0a6a3e42165de70c354f94e7c5d541a1
TEKSTI	ae769171c7850ae0399a1b2d6213ab14097fdd006ada00699213e8605e4c7cfff
PAMJA	c44462e2092ebfff497b828206872d46ed5f8dda20ec68fbabe4eb3aea0e5c5df

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86f2c3815e1eb5db8e250d82e10d676a5107189e82f8cd6af6487c66fa957a16
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/86f2c3815e1eb5db8e250d82e10d676a5107189e82f8cd6af6487c66fa957a16>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

IA VLEN: Platforma shqiptare po lehtëson vendimet financiare

Nga A2 CNN
15 Shtator 2026, 16:21 | Teknologji



Nga kreditë dhe sigurimet te investimi në prona, platforma shqiptare **IA VLEN** po zgjeron modelin e saj të krahasimit dhe orientimit financiar. Hapi i radhës është "Prona që **IA VLEN**", një seksion i dedikuar tregut të pasurive të paluajtshme.

Në Shqipëri nuk mungojnë ofertat. Ajo që mungon shpesh është koha për t'i kuptuar dhe krahasuar ato.

Një normë interesi gjendet në faqen e një banke, komisionet diku tjetër, për këstin duhet një telefonatë, ndërsa në fund vendimi shpesh përfundon te këshilla e një mikut që "i njeh këto punë".

Pikërisht këtë rrugë kërkon të shkurtojë **IA VLEN**.

Aktive online që prej vitit 2024, platforma është ndërtuar mbi një parim të thjeshtë: përpara një vendimi financiar, përdoruesi duhet të ketë mundësinë të informohet, të krahasojë alternativat dhe më pas të zgjedhë vetë.



TE FUNDIT

Zjarr në një fshat në Gjirokastër, rrezikohen banesat

Politikanët në "darët" e SPAK, Gjykata e Lartë nuk liron Erion Veliajn, GJKKO Ilir Metën

Shteti i së drejtës në filma, lufta dhe paqja, thirrja artistike e Kujtim Çashkut

Huthët rrezikojnë rajonin, shtohen sulmet ndaj Arabisë Saudite

MË TË VIZITUARAT

Ebola në Kongo, rëndohet bilanci, 3,510 viktima, OKB paralajmëron për muajtë...

Planet e votimit me postë, Trump pëson humbje para Gjykatës së Lartë

Fillon lufta e "yjeve", ushtria amerikane zbulon se ka armë në hapësirë

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

ose mundësi investimi.

Çfarë të prisni

- ✓ Apartamente, shtëpi, dhe tokë
- ✓ Filtroni sipas vendndodhjes dhe çmimit
- ✓ Kontakt direkt me shitësit

Sot, **IA VLEN** përfshin kredi personale, kredi për shtëpi, financim automjeti, mikrokredi, depozita, sigurime dhe kategori të tjera, duke mbledhur në një hapësirë të vetme informacion që zakonisht do të kërkonte disa kërkime të veçanta.

IA VLEN nuk është bankë dhe nuk jep kredi. Roli që kërkon të ndërtojë është ai i ndërmjetësit të informacionit mes konsumatorit dhe tregut.

“Nuk kemi interes të zgjedhim në vend të klientit. Duam t’i kursejmë kohë dhe t’i japim informacionin që i duhet për të marrë një vendim më të qartë”, thotë themeluesi i platformës, Admir Daka.

Nga krahasimi të orientimi

Ambicia e **IA VLEN** shkon përtej një faqeje klasike krahasimi.

Synimi është që platforma të kthehet gradualisht në pikën e nisjes për vendimet financiare të konsumatorit shqiptar: kur dikush kërkon një kredi, dëshiron të financojë një automjet, ka kursime për të investuar apo kërkon të blejë një pronë.

Në njëfarë mënyre, vizioni është ai i një “Google-i të vendimeve financiare”: jo një motor kërkimi në kuptimin tradicional, por një platformë ku përdoruesi nis kërkimin kur përballë ka disa alternativa dhe duhet të kuptojë se cila i përshtatet më shumë.

Mikrokreditë

€
Euro

L
Lek

Qëllimi i Kredisë

Personal

Biznes

Shuma e Kredisë

€ 100000

€100€10K

€500

€1K

€2K

€5K

€10K

Modeli është i njohur ndërkombëtarisht. Platforma si CHECK24 në Gjermani, Facile.it në Itali apo MoneySuperMarket në Mbretërinë e Bashkuar e kanë kthyer prej vitesh krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare në një industri të konsoliduar.

IA VLEN kërkon ta përshtatë këtë logjikë me tregun dhe sjelljen e konsumatorit shqiptar.

Edhe emri i platformës është ndërtuar rreth pikërisht këtij koncepti. Sepse, pas normave të interesit, komisioneve, kësteve dhe përlogaritjeve, pyetja e konsumatorit është shumë më e thjeshtë: A ia vlen?

Eksperiencia pas platformës

Pas **IA VLEN** qëndron edhe eksperiencia profesionale e themeluesit të saj, Admir Daca, i formuar në Itali në Corporate Management.

Gjatë eksperiencës së tij në Itali, Daca ka punuar me Google dhe Unioncamere, duke qenë person referues për rajonin ku jetonte në kuadër të një projekti kombëtar të lidhur me Expo Milano.

Pas rikthimit në Shqipëri, për rreth një dekadë ai drejtoi një projekt kompleks me shtrirje kombëtare, duke bashkëpunuar me aktorë ndërkombëtarë, kompani të listuara në bursë dhe operatorë të rëndësishëm të sektorëve të ndryshëm.

“Kur ke punuar në struktura ku vendimet duhet të jenë të matshme dhe proceset duhet të funksionojnë, fillon ta vlerësosh shumë thjeshtësinë. **IA VLEN** vjen edhe nga kjo eksperiencë”, thotë Daca.

Pjesa teknologjike e platformës është zhvilluar nga Enid Mero, CTO i **IA VLEN**, ndërsa paralelisht është ndërtuar edhe modeli komercial dhe rrjeti i partnerëve.

Në ekosistemin e platformës janë përfshirë partnerë si ALBSIG në sigurime dhe San Pietro Booking-Grand Stay Collection në turizëm dhe rezervime, ndërsa synimi është zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimeve me institucione financiare dhe kompani të tjera.

Modeli funksionon mbi një marrëdhënie të drejtpërdrejtë interesi: përdoruesi fiton akses më të shpejtë në informacion dhe alternativa, ndërsa partneri lidhet me një klient që ka tashmë një interes konkret për produktin apo shërbimin.

Në këtë mënyrë, **IA VLEN** synon të jetë njëkohësisht një shërbim i dobishëm për konsumatorin dhe një model biznesi i aftë për t'u zgjeruar.

Platforma është e aksesueshme në web, si dhe përmes aplikacioneve për iOS dhe Android.

Hapi i radhës: “Prona që **IA VLEN**”

Pas produkteve financiare, platforma po hyn tashmë në një prej vendimeve më të rëndësishme ekonomike që merr një individ apo një familje: blerjen e një prone.

Projekti i ri, **IA VLEN** Properties – “Prona që **IA VLEN**”, do të ketë në fazën e parë një fokus të veçantë te bregdeti shqiptar, por me synimin për t'u shtrirë më tej.

Edhe në këtë rast, ideja nuk është krijimi i një tjetër portali me mijëra njoftime.

Qasja është përzgjedhja dhe strukturimi i informacionit.

Përdoruesi duhet të mund të kuptojë jo vetëm çmimin për metër katror, por të krijojë një panoramë më të plotë: ku ndodhet prona, kush e zhvillon projektin, çfarë arkitekture ofron, si është planimetria, si strukturohet pagesa, kur parashikohet dorëzimi dhe, kur është e mundur, cilat janë alternativat e financimit.

Blog

Njohuri Financiare

Të gjitha

Financa Personale

Investime

INVESTIME 4 min lexim

Si të zgjedhësh financimin më të mirë me IA VLEN?

Zgjedhja e financimit të duhur fillon nga krahasimi. Me IA VLEN mund të orientoresh më shpejt mes ofertave për kredi, leasing apo produkte të tjera financiare, duk...

8 qershor 2026



"Një pronë nuk është vetëm €/m². Është një vendim financiar. Dhe nëse **IA VLEN** flet për vendime financiare, ishte e natyrshme që një ditë të arrinim edhe këtu", shpjegon Daka.

Pikërisht te prona bashkohen dy shtyllat mbi të cilat platforma kërkon të ndërtojë fazën e saj të ardhshme: financimi dhe investimi.

Një përdorues mund të nisë kërkimin nga prona dhe më pas të kërkojë mënyrën e financimit. Një tjetër mund të nisë nga buxheti që ka në dispozicion dhe të kërkojë se çfarë mund të blejë me të.

IA VLEN kërkon të pozicionohet mes këtyre dy pyetjeve, duke ofruar informacion, krahasim, orientim dhe, mbi të gjitha, kursim kohe.

Kjo është edhe logjika që përmbledh seksionin e ri: Prona që **IA VLEN**.

Në fund, pyetja mbetet e njëjtë


Nga një platformë krahasimi financiar, **IA VLEN** po ndërton gradualisht një ekosistem më të gjerë, ku kreditë, sigurimet, kursimet, financimi, partnerët dhe tashmë pronat lidhen rreth të njëjtit parim: Më shumë informacion përpara vendimit.

Kategoritë mund të shtohen. Teknologji mund të evoluojë. Partnerët mund të bëhen më të shumtë dhe shërbimet më të sofistikuara.

Por pyetja mbi të cilën është ndërtuar platforma mbetet po aq e thjeshtë sa në ditën e parë: A ia vlen?

Dhe Admir Daka e përmbledh filozofinë e biznesit me një fjali: "Nëse ia vlen, shumë mirë. Nëse nuk ia vlen, akoma më mirë ta kuptosh para se të paguash". (**A2 Televizion**)

Galeria fotografike ()



 Kontakt direkt me shitësit

A2 CNN Livestream

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.